



VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 29 shkurt 2016

Lënda nr. 2014-36

Z.A.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 shkurt 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 19 gusht 2014. Ankuesi ka kërkuar që të mos bëhet i ditur identiteti i tij. Duke shqyrtuar çështjen, në veçanti natyrën e akuzave të bëra, Paneli është i bindur se kërkesa duhet të pranohet.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës të parashtruara nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijim.
3. Me 17 shtator 2010, ankuesi ka parashtruar kërkesën për pranimin e statusit të tij si veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në degën e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së në Pejë.
4. Me 12 tetor 2010, ankuesi ka parashtruar ankesë në zyrën qendrore të veteranëve të UÇK-së në Prishtinë, duke u ankuar për mosveprim nga ana e zyrës lokale.
5. Me 13 dhjetor 2010, ankuesi ka parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë dhe ka pohuar se nuk kishte pranuar vendimin nga zyra qendrore e veteranëve të UÇK-së.
6. Me 28 dhjetor 2010 dhe me 29 janar 2011, ankuesi ka parashtruar ankesë te Inspektorati Gjyqësor i Kosovës kundër mosveprimit të Gjykatës Supreme.
7. Me 9 shkurt 2011, ankuesi ka pranuar një letër nga Zyra e Këshillit Disiplinor të Inspektoratit Gjyqësor të Kosovës, duke e informuar atë se ankesa e tij nuk i kishte përmbushur kriteret e pranueshmërisë.
8. Me 9 shkurt 2011, ankuesi bëri një kërkesë shtesë tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke kërkuar që të shqyrtohen ankesat e tij të datave 28 dhjetor 2010 dhe 29 janar 2011.
9. Më 3 mars 2011, ankuesi ka paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
10. Më 20 prill 2012, Gjykata Kushtetuese refuzoj kërkesën e ankuesit si të papranueshme.
11. Më 25 mars 2013, ankuesi parashtror një ankesë kundër Organizatës së Veteranëve të UÇK-së në EULEX. Më 7 prill 2013, ai pranoi një përgjigje nga Zyra e Shefit të Stafit të EULEX-it. Ai u njoftua se lënda nuk hyn në kuadër të juridiksionit dhe përgjegjësive të Misionit të EULEX-it.

III. ANKESAT

12. Ankuesi thirret në një numër të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, Deklaratës së të Drejtave të Njeriut, Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike.
13. Në thelb, ai kërkon që t'i njihet statusi i veteranit të UÇK-së.

IV. LIGJI

14. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të zbatuar instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të jen të garantuara nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
16. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
17. Paneli thekson se ankesat e ankuesit në fjalë kanë të bëjnë me një kontest mes tij dhe Organizatës së Veteranëve të UÇK-së në lidhje me statusin e tij të veteranit. Ankuesi pa sukses ishte përpjekur të sillte rastin e tij para gjykatave të Kosovës. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli në parim nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në rezultatin e procedurave gjyqësore apo shpejtësinë me të cilat ankesat në pritje shqyrtohen nga gjykatat e Kosovës. Edhe pse gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera [Gani Zeka kundër EULEX-it](#), 2013-15, 4 shkurt 2014, § 13; [Shaban Kadriu kundër EULEX-it](#), 2013-27, 27 maj 2014, § 17).
18. Ankesa e dorëzuar në EULEX, e përmendur në par. 11 më sipër, nuk ka nxitur juridiksionin e Panelit për ta shqyrtuar lëndën. Së pari, çështja e ngritur në atë letër në dukje të parë nuk duket se bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të Misionit. Së dyti, kur i është përgjigjur letrës së ankuesit, shefi i stafit të EULEX-it nuk ka ushtruar autoritet ekzekutiv në kuptim të Konceptit Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, pasi ai thjesht ka informuar ankuesin se çështja nuk ka hyrë në kuadër të juridiksionit të EULEX-it (krahaso për shembull [Ajet Kaçiu kundër EULEX-it](#), 2014-26, 2 shkurt 2015, § 19 ose Shaban Kadriu, cituar më lartë, § 18).

19. Nga kjo del se ankesa bie jashtë kuadrit të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri, konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi ajo bie jashtë juridiksionit të tij brenda kuptimit të nenit 29 (d) të Rregullores së Punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese